

FORMULARI NUMËR 3

KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Emri:	Sanije
Mbiemri:	Gashi Seferi

I. Analiza juaj, si vijon:

Unë para jush do ta paraqes vizionin tim për udhëheqjen e Prokurorisë Themelore në Pejë, ku në këtë koncept dokument do të paraqes në detaje për objektivat të cilat synoj ti arrij gjatë punës sime si menaxhere- Kryeprokurore e Prokurorisë për të cilën kam aplikuar, ku synim parësor në punën time do të jetë lufta kundër krimit në përgjithësi me theks të veçante luftimi i korrupsionit, dhunës në familje dhe veprat penale kundër integritetit seksual dhe unë duke qenë në këtë funksion do të veproj duke u bazuar në parimet e pavarësisë, paanësisë, integritetit, të lartë profesional e moral llogaridhënës dhe transparencë.

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

Prokurori i shtetit ka kaluar nëpër sfida të ndryshme, me ndryshime ligjore, duke zbatuar praktikat ndërkombëtare e që është arritur që të përmbushet resursi njerëzor me përmirësim të kushteve të punës, është ngritur besimi në publik pas trajtimit të rasteve komplekse dhe të ndjeshme duke bazuar në Kushtetutë dhe ligjet përkatëse që kjo fushë ligjore ia mundëson Prokurorit të Shtetit të veprojë si organ i pavarur në punën e tij. Patjetër që ka nevojë edhe tutje të ketë reforma duke u bazuar në sugjerimet ndërkombëtare në mënyrë që të rritet integriteti në Prokurorinë e shtetit, fuqizimi i sigurisë në punë për Prokurorët dhe plotësimi i kushteve të punës për të njëjtët. Prokurori i shtetit me mbështetjen e fuqishme të partnerëve ndërkombëtarë është fuqizuar dhe ka avancuar në një zhvillim të qëndrueshëm por që kërkon tutje kontribimin e Prokurorit të shtetit për zhvillim të mëtutjeshëm duke përpiluar plane të punës dhe gjithnjë të rrisë llogaridhënien e integritetit duke respektuar Kodin e etikës. Në aspektin organizativ dhe funksional Sistemi Prokurorial janë përqendruar në Pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit Prokurorial është garantuar me kushtetutë, organizimi, funksionimi dhe kompetenca të përcaktuara me ligje, është rritur në mënyrë të dukshme numri i prokurorëve dhe stafit mbështetës dhe ka përparime të dukshme në politikat e avancimit profesional, ka rezultate pozitive në sistemin e rekrutimit, avancimit dhe disiplinimit të prokurorëve dhe kjo është arritur me kornizën ligjore dhe vullnetin këmbëngulësinë në zbatimin e kësaj kornize ligjore, -Sistemi i futjes të dhënave, përpunimit që bazohet kryesisht në teknologjinë informative, planifikimi i buxhetit dhe infrastruktura bazike janë në gjendje të

qëndrueshme për të garantuar funksionalitet të plotë dhe bashkëpunim të mirë me institucionet vendore dhe ndërkombëtare përfshirë edhe donatorët.

2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë që keni aplikuar?

Proceset e punës në Prokurorinë Themelore në Pejë janë fuqizuar dukshëm në vitet e fundit. Kjo edhe si rezultat i ndryshimeve pozitive që kanë ndodhur me strukturimin e prokurorisë por edhe me qasjen proaktive ndaj sfidave të evidentuara. Marrë në konsideratë se janë identifikuar dhe analizuar saktë problemet e kësaj prokurorie, kanë mundur që të përcaktohen politikat dhe strategjitë adekuate dhe që kanë dhënë rezultate të prekshme. Sot prokurorët e shtetit janë të profilizuar dhe kjo ndikon edhe në rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit të tyre, mirëpo ka vështirësi në numrin e vogël të Prokuroreve në departamentin e përgjithshëm ku aktualisht funksionon më 6 prokuror të cilët përfaqësojnë në 4 komuna duke përfshirë Pejën, Klinën, Deçanin dhe Istogun, Nga viti në vit shënohet progres në trajtimin e lëndëve, duke ju dhënë prioritet rasteve të dhunës në familje dhe atyre të korrupsionit, për çka edhe është vepruar dhe zgjedhur shpejt këto raste. Është fuqizuar bashkëpunimi me institucionet e sundimit të ligjit e sidomos me policinë. Po ashtu janë krijuar raporte të mira bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtar, ku në veçanti kanë përfituar prokurorët përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të përvojave. Andaj sfida më te cilën ballafaqohemi është mungesa e numrit të mjaftueshëm të prokuroreve dhe që vlerësoj se duhet të rritet numri i tyre, kështu që si drejtues i kësaj prokurorie me ndihmën edhe të KPK-së duhet të adresohet kjo sfida, duke bërë planifikimin e numrit të nevojshëm të Prokuroreve në prokurori dhe atë për një periudhë afat shkurte dhe afatgjate dhe nevojave tjera për punë normale në prokurori dhe duhet të insistohet në realizimin e tyre.

3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

Përkundër sfidave dhe vështirësive që është ballafaquar Prokuroria Themelore në Pejë, është përpjekur dhe vlerësoj që edhe ka arritur të krijoj një ambient të qetë dhe të sigurt ndërsa ka krijuar ambient armiqësor për të gjithë kryesit të veprave penale të cilët kanë tentuar të rrezikojnë jetën, sigurinë, dhe pronën e qytetarëve të këtij regjioni, dhe një sukses i tillë ka qenë i mundshëm vetëm me punën e palodhshme të gjithë prokuroreve të kësaj prokurorie dhe stafit mbështetës, në bashkëpunim të ngushtë dhe korrekt edhe me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit, para se gjithash Policinë Kosovës me të gjithë sektorët e tij, Gjykatën Themelore në Pejë me Degët e saj dhe institucionet Komunale të këtij regjioni dhe institucionet tjera relevante të zbatimit të ligjit por për arritjen e luftimit të sfidave mbështetja e institucioneve të zbatimit të ligjit duhet të jetë më fuqishme dhe më e strukturuar. Nevoja për riorganizim dhe ngritja e kapaciteteve të resurseve aktuale për planifikim dhe mbikëqyrje të procesit të punës në fokus të veçantë në drejtim të rritjes të cilësisë, efikasitetit dhe efektivitetit të punës. Prokurorët dhe personeli administrativ duhet të vazhdojë të mbështetet me njohuri profesionale dhe praktikat e vendeve të zhvilluara

duke përcjelle trajnime të ndryshme duke i trajnuar në zbatimin dhe përshtatjen e prokurorisë me ndryshimet në legjislacionin e KPK-së.

4. A mendoni se strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e Prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

Strategjitë aktuale paraqesin nevojë që të përditësohet dhe të plotësohet duke i adresuar qartë nevojat, vështirësitë por edhe zgjidhjet e duhura për tejkalimin e tyre. Po ashtu proceset e punës për rritjen e efikasitetit të rrjedhës së lëndës dhe në përgjithësi për punën e kësaj prokurorie janë të rëndësishme të adresohen nga të gjithë mekanizmat udhëheqës të sistemit prokurorial. Si i gjithë sistemi i drejtësisë ashtu edhe sistemi Prokurorial në veçanti ka kaluar nëpër shumë reforma, është ballafaquar me sfida të ndryshme si numri i madh i lëndëve të pakryera, numri i pamjaftueshëm të prokurorëve dhe stafit administrativë, kështu që përball numrit të madh të lëndëve të pranuar kishte vonesa në kryerjen e tyre, dhe kjo ka shkaktuar që raportet vendore dhe ndërkombëtare sistemin tonë prokurorial ta vlerësojnë si sistem të konsoliduar me progres shumë të vogël, dhe kjo ka bërë që sistemi prokurorial të ndërmerr masa konkrete drejtë fuqizimit të sistemit në aspektin, pavarësisë, paanshmërisë, paanësisë, integritetit, llogaridhënies, efikasitetit, transparencës, dhe profesionalizmit. Strategjitë aktuale të sistemit i adresojnë nevojat politikat institucionale dhe menaxhmentit të tij krahasuar me strategjitë dhe kornizat e politikave të institucioneve në nivel shtetëror, nga qe koordinimi i tillë siguron në planifikim të drejtë dhe të saktë i cili është garantues për rezultate pozitive. Prokuroria Shtetit dhe KPK-ja në vazhdimësi punojnë për përcaktimin e prioriteteve dhe kriteret për shqyrtim të lëndëve në përgjithësi për të gjitha Prokurorit të Kosovës, por nëse zgjidhem Kryeprokuror në bashkëpunim me KPK-në do të vendos edhe prioritetet specifike të PTH -së në Pejë, duke u bazuar në natyrën e rasteve të pranuar dhe dukurive kriminale të shfaqura në territorin që mbulon Prokuroria Themelore e Pejës

II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në Prokurorinë që keni aplikuar?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj :

- Vlerësimi i strukturës dhe gjendjes aktuale në prokurori do të jetë hapi i parë në këtë proces, ku do të përfshijë një analizë detale të strukturës aktuale të personelit dhe efikasitetit të tij në përmbushjen e shërbimeve në emër të llogaridhënës në prokurori, ku rekomandimet përfundimtarë të kësaj analize do të shërbejnë për hartimin e strategjive në eliminimin e mangësive brenda Prokurorisë Themelore në Pejë
- Të ofrohet trajtim i barabartë para ligjit mënyrë efikase, transparente, llogaridhënëse, dhe profesionale e cila siguron besimin e publikut

- Të rritet cilësia hetimit të veprave penale të krimeve ekonomike dhe korrupsionit
- Do të forcohen mekanizmat për mbikëqyrjen e prokurorëve dhe stafit administrativ të Prokurorisë;
- Rritja e bashkëpunimit më akteret e drejtësisë dhe rritja e komunikimit me media dhe publikun por me kujdes maksimal pa dëmton procesin hetimor

Hapat që do të ndërmerren në dy vitet e para:

Së pari do të analizohen të arriturat dhe dështimet eventuale të vitit paraprak, duke u përpjekur që të mos përsëriten dështimet e vitit paraprak, por do të veprojë që të arriturat e vitit paraprak të përsosen dhe që në të ardhmen të fitohen praktikat më të mira në aspektin menaxherial.

Hapat që do të ndërmerren deri në fund të mandatit:

Nëpërmjet ndërmarrjes të hapave të mësipërm deri në fund të mandatit do të bëjë përpjekje për të krijuar një prokurori e cila do të jetë e pavarur, transparente, llogaridhënëse dhe efikase, e cila nëpërmjet të zbatimit të këtyre parimeve me punën e saj do të ofrohet më shumë standardeve evropiane, me çka do të kontribuon drejtpërdrejt në krijimin e një sistemi Prokurorial i cili do të respektohet si nga institucionet vendore ashtu edhe nga ato ndërkombëtare

2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?

Objektivat e mia kryesore do të kenë në fokus hetimin dhe ndjekjen e suksesshme të kryesve të veprave penale si dhe administrimin efikas dhe të shpejtë të prokurorisë si dhe, duke krijuar kushte pune adekuate dhe mundësi për zhvillim profesional e fuqizim të llogaridhënies së prokurorëve dhe personelit mbështetës.

Planifikimi dhe organizimi i punës së Prokurorisë Themelore mbështetet në objektivat në vijim:

- Do të marre si synim krijimin e një modeli më të përshtatshëm sipas nevojave të Prokurorisë duke u bazuar në praktikat më të mira, në menaxhimin e lendeve dhe atë krijimit të kushteve dhe koordinimit të stafit për të arritur tek sukseset që pretendojmë, kjo do të mund të arrihet duke marre për baze që nga pranimi i lendes në Prokurori, respektimi i afateve, zhvillimi i hetimit në mënyrën me profesionale deri në përfundimin e tyre, vendosjen në mënyrën elektronike që ndihmojnë jashtëzakonisht në efikasitetin e trajtimit të rasteve në këtë drejtim do të ofroj mbështetje secilit prokuror, kjo do të arrihet më bashkëpunimin:
 - Bashkëpunimi me institucionet e sundimit të ligjit në rritjen e cilësisë të kallëzimeve penale dhe të hetimeve efektive
 - Bashkëpunimi me institucionet përkatëse për kryerjen e ekspertizave në

kohë Mjeko- Ligjore , shkencore forenzike

- Unifikimi praktikave të punës brenda Prokurorisë
- Rritja e numrit të procedurave të sekuestrimit dhe konfiskimit duke bërë zbatimin efektiv të këtyre procedurave dhe rritja e numrit të procedurave alternative për zgjedhjen e rasteve përmes zbatimit efektiv të tyre.
- Prioritet në hetimin të veprave penale dhe ndjekjen e kryesve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, trafikimit me qenie njerëzore, veprave penale kundër integritetit seksual ,dhunës në familje, etj
- Të këtë numër adekuat të prokuroreve dhe personelit mbështetës ne përputhje me ngarkesën e punës së Prokurorisë,
- Rritja e llogaridhënës , profesionalizmit dhe transparencës po ashtu do të ofroj një kulturë të komunikimit më secilin prokuror nga ana e ime më qellim të ofrimit te informacioneve te nevojshme.
- Zbatimin e model projektit apo pilot projektit ne profilizimi dhe specializimi i prokurorëve në fusha të caktuara
- Si i drejtuese e institucionit të Prokurorisë, do të angazhohem të shfrytëzoj në mënyrë efektive të gjitha burimet, jo vetëm atyre njerëzore por edhe atyre buxhetore të objekteve dhe pajisjeve të cilat janë në shfrytëzim të Prokurorisë po ashtu do të angazhohem që me ndihmën edhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Sekretariatit të tij të bëjë planifikimin e burimeve njerëzore dhe planifikimin e stafit të nevojshëm për prokurorinë të cilin do ta drejtoj dhe atë për një periudhë afatgjate dhe nevoja tjera për punë normale në këtë prokurori.
- Një nga objektivat kryesore do të jetë që Institucioni i Prokurorisë duhet të rifitojë besimin te publikut cili është shumë i rëndësishëm, sepse do t'i bëjë prokurorët e shtetit të ndihen më të sigurt në punën e tyre dhe do të kenë autoritet dhe kredibilitet më të madh. Ky besim do të arrihet duke treguar rezultate të mira në zbulimin dhe ndjekjen e kryerësve të veprave penale.Më punën e përditshme prokurorët duhet të forcojnë perceptimet e përgjithshme se veprimet e prokurorëve janë të drejta, ligjore dhe të përshtatshme komfor kodit të etikës dhe dispozitave tjera ligjore, dhe kjo do të bëjë që qytetarët të kenë besimin në procedurat e ndjekjes të cilat ndermirën nga ana e prokurorëve të shtetit, prandaj do të angazhohem për të siguruar që prokurorët të jenë në gjendje të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre profesionale pa ndërhyrje nga askush. Besimi i publikut fitohet duke promovuar prokurorë të cilët tregojnë performancë të mirë, profesionalizëm dhe integritet moral dhe për ta realizuar këtë objektiv duhet punuar në drejtim të përfitimit të përkrahjes së mediave dhe opinionit publik.
- Po ashtu rol shumë të rëndësishëm dhe prioritet do ti kushtohet trajtimit të rasteve të dhunës në familje, në mënyrë që mos të tolerohet asnjë lëshim në drejtim të trajtimit të këtyre rasteve dhe padyshim në këtë aspekt do të ketë shumë rëndësi bashkëpunimi me Polici dhe institucione tjera relevante që merren kryesisht me trajtimin e dhunës në familje.

- Si drejtuese e kësaj prokurorie do të përpiqem maksimalisht që të rritet numri i rasteve të zgjidhura në procedurën alternative edhe pse deri më tani kjo prokurori ka qenë e përkushtuar në kryerjen e lëndëve përmes procedurave alternative, siç janë: marrëveshja për praninë të fajësisë dhe ndërmjetësimi e po ashtu edhe tek procedura për të mitur më masa të diverzitetit, do të motivoj prokuroret që ta aplikojnë sa më shumë edhe vërejtjen policore si masa e re e zgjidhje në mënyrën alternative etj. Do të përpiqem që si drejtuese e kësaj prokurorie të vazhdohet me këtë përkushtim, duke inkurajuar palët çështjet e tyre të zgjidhin përmes këtyre procedurave, kjo gjithnjë duke i respektuar dispozitat ligjore, pasi vlerësoj se zgjidhja e lëndëve përmes procedurave alternative ka efekt të drejtpërdrejt në shkurtimin e kohës jo vetëm për institucionin e prokurorisë por edhe të gjykatave, duke ndikuar në efikasitetin e vendosjes me shpejtësi të këtyre lëndëve.
- Edhe pse nga kryeprokurori paraprak janë bërë përpjekje për ta aplikuar modelin “një gjyqtarë- një prokuror”, e që nuk është arrit në mënyrë shumë efektive ngase kemi pas kritikave në mungesë të prokuroreve në përfaqësime do të angazhohem për ta implementuar këtë model duke bashkëpunuar me eprrorët e gjykatave që mbulon kjo prokurori pasi vlerësoj se ky model veprimi do të ndikoj në vendosjen e rasteve me shpejtësi, me pak kohë të humbur dhe numër më të madh të rasteve të zgjidhura.
- Rezultate të mira kjo prokurori ka shënuar në sekuestrimin dhe konfiskimin e sendeve, pasurisë e cila është fituar me veprën penale, por edhe në të ardhmen do të angazhohemi duke insistuar nga prokuroret lëndor që këto pasuri të konfiskohet aty ku ka bazë ligjore për këtë.
- Për vitet e ardhshme do të ishte shumë më rëndësi të zbatohet si model projekt apo pilot projekt profilizimi dhe specializimi i prokuroreve në fusha të caktuara që do të ndikonte në rritjen e efikasitetit në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultate konkrete e të pritshme nga institucioni i prokurorisë, ashtu që menjëherë nga gjysma e dytë e vitit të ardhshëm do të provohet të behet ndarja e prokuroreve në këto lëmi:
- Një prokuror vetëm për lëndët me vepra penale trafikim me qenie njerëzore ,dhe për vepra penale që ka të bëjmë e trafikim me substanca narkotike;
- Një prokuror vetëm për lëndët me vepra penale nga deliktet ekonomike, krim i organizuar dhe korrupsionit dhe për veprat penale kibernetike;
- Një prokuror i cili do të vendoste për të gjitha veprat penale tjera me kompetencë nga departamenti për Krime të Rënda.
- Dhe një Prokuror që do të jete nga departamenti për të Mitur për veprat penale kundër integritetit seksual.

3. Cilat janë sfidat që i prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektivave ?

Edhe pse jam e vetëdijshme se një ndarje e tillë e prokuroreve në fillim pa dyshim do

të ketë vështirësi, por me kalimin e kohës shumë shpejtë në një të ardhme do të prodhoj rezultate shumë pozitive dhe të pritshme në institucionin e prokurorisë. Në realizimin e objektivave të dhëna në këtë koncept dokument duhet të llogarisë edhe në sfida që herë pas here paraqiten si pengesë dhe sfidojnë punën e suksesshme të institucionit të prokurorisë dhe mundësinë për tejkalimin e tyre. Këto do të tejkalohen në koordinim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Sekretariatit e Këshillit Prokurorial.

5. Si do t'i tejkaloni ato?

Bashkëpunimi në sferën e infrastrukturës ligjore është tejet i rëndësishme në planifikimin e punëve dhe tejkalimin e sfidave në prokurori, duke i kushtuar rendësi të veçantë transparencës dhe llogaridhënies, rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë si faktorët kyq për rritjen e rezultateve dhe përmisimin e punës në Prokurori. Do të kërkoj nga prokurorët efektivitet në punë me qellim të zvogëlimit të numrit të lëndëve të grumbulluara, duke u kujdesur për afatet e parashkrimit, do të kërkoj raporte për lëndët që kanë në punë sidomos kryerjen në afat të arsyeshëm të lëndëve me prioritet, do tu caktohet afate kohore për zvogëlimin e numrit të lëndëve, do tu kërkohet aplikimin e me të madh të procedurave alternative me qellim tu shmangen seancave të gjata gjyqësore kështu që të fitojnë kohë për hetime të mirëfillta dhe cilësore të rasteve në punë do të kenë një koordinim të ngushtë më bashkëpunëtorët të cilët do t'iu ndihmojnë në punën më efikase të prokuroreve. Me qellim të aplikimit të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së fituar me veprën penale do ti inkurajoj prokurorët të bashkëpunojnë me koordinatorin Regjional për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale duke insistuar të organizojnë trajnime intensive në këtë fushë. Sa i përket rritjes së cilësisë në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar do të insistoj të vendosen kontakte me institucione e Prokurorive të rajonit duke shkëmbyer përvojat ma të mira dhe duke u përpjekur që ti shmangen formalitetet ligjore të cilat zgjasin shumë shpesh herë rezultatet janë të mangëta, pasi vlerësoj se krijimi dhe mbajtja e kontakteve do ti kontribuoj shumë shkëmbimit të informacioneve dhe përvojave të mira e që si qellim final të përbashkët kanë zbulimin e veprave penale dhe kapjen e kryesve dhe sjelljen e tyre para organeve të drejtësisë.

III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj :

1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?

Administrimi profesional në sistemit prokurorial është faktor me rendësi që ndikon në efektivitetin e punës të prokurorive dhe për këtë arsyeje puna e personelit të administratës duhet të forcohet në drejtim të rritjes së efektivitetit të punës së tyre dhe të ketë llogaridhënie të shtuar. Në këtë drejtim fokusi i sistemit prokurorial do të jetë në rishikimin e strukturës organizative të administratës të sistemit prokurorial në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, digjitalizimin të procesit të punës,

fuqizimin e llogaridhënies dhe vlerësimin e përfomances edhe pse ky proces i rishikimit mund të krijoj nevojën për buxhet dhe burime njerëzore shtesë. Procesi i planifikimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afat gjatë konsiderohet si një mundësi për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në punë, prandaj duhet të kushtohet kujdes përmbyshjes të këtij qëllimi duke organizuar trajnime për stafin e administratës të prokurorive

2 Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?

Ndarja e punëve për stafin administrativ do të bëhet duke respektuar standarde të njohura për një shpërndarje të barabartë të punës pa bërë kompromis me nevojat prioritare dhe kërkesat ligjore lidhur me afatet e zhvillimit të punëve të prokurorëve rreth lëndëve si dhe zbatimin e objektivave të përcaktuara me planin e punëve, pasi që me aplikimin e sistemit elektronik të menaxhimit të lëndëve është rritur dukshëm puna administrative në prokurori, punë kjo që kërkon numër të madhe të stafit administrativ dhe përgatitje profesionale me të avancuar. Në bashkëpunimin me Administratorin e prokurorisë do të bëhet ndarja e punëve në mënyrë transparente dhe të barabartë duke marrë për bazë rëndësinë e secilit Departament.

3.Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

Stafi administrativ do të jetë në fokus të vazhdueshëm për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të punës me profesionalizëm dhe etikë të lartë dhe raportet të rregullta do të kërkohen edhe raporte specifike për punë dhe procese të cilat synoj të arrijnë pasqyrim të saktë të rrjedhave për zgjidhje të lëndëve dhe performancë të Prokurorisë. Do të punohet që të gjitha profilet e stafit të marrin trajnime të nevojshme, të kenë kushtet e duhura për punë si dhe të avancojnë shkathhtësitë e tyre vazhdimisht duke qenë se suksesi i ushtrimit të drejtë të funksionit të prokurorisë varët edhe nga puna e stafit mbështetës të Prokurorisë.

IV. Hapat që do të ndërmerri për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit, prokurorisë dhe besimit të publikut?

Gjatë kohës sa do të ushtroj detyrën e Kryeprokurores në PTH në Pejë do të përpiqem të ndërtoj raporte të mira dhe të besueshme ndër njerëzorë, kolegiale me të gjithë prokuroret dhe stafin administrativë që është pjesë e organit. Do të përpiqem të ruaj dinjitetin e funksionit të prokurorit, ta ruaj pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre, por duke kërkuar gjithherë zbatimin e përpiktë të ligjit dhe të respektojnë në praktik të drejtat procedurale, të drejtat që i takojnë secilit person, pavarësisht se kush është dhe në çka beson. Do të kërkoj sjellje dhe integritet, korrektësi sjellje të pranueshme si në zyre ashtu edhe jashtë saj, duke treguar shembull për të tjerët, po ashtu duke vendosur të gjitha çështjet në mënyrë të paanshme dhe të drejtë, bazuar vetëm në prova dhe argumente të bazuara në ligj,

jashtë çdo ndikimi apo presioni, frikë apo kërcënimi nga kushdo çoftë. Do të kërkoj nga të gjithë prokurorët të këtij institucioni që punën e tyre mos ta ushtrojnë duke ju përshtat interesave personale, çoftë interesave të personave të tretë që kanë interesa në procedurën hetimore, por punën e tyre ta ushtrojnë me profesionalizëm pa qenë i ndikuar nga askush. Do të angazhohem që një prokuror të jetë me integritet, i pavarur edhe në aspektin institucional, duke ruajtur autoritetin dhe imazhin e sistemit prokurorial dhe njëkohësisht do të rritet besimi i publikut në institucionin e prokurorisë.

1.Çfarë hapash do të ndërmerri për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?

Nga prokurorët do të kërkohet llogaridhënie për rezultatet e punës së tyre duke u bazuar në profesionalizmin dhe në përgjegjësi në ushtrimin e detyrave të tyre por vlerësoj se komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet tjera të zbatimit të ligjit, publikun organizatat dhe shoqërinë civile, duhet të vazhdohet edhe në të ardhmen, dhe ky bashkëpunim duhet të jetë shumë ma efektiv, që do të ndikonte edhe më tepër në ngritjen e besueshmërisë së opinionit në institucionin e Prokurorisë dhe krejt sistemit Prokurorial në Kosovë. Transparenca dhe komunikimi me media duhet të vazhdohet të behet në atë mënyrë, që publiku të njoftohet për të gjithë veprimtarinë e sistemit Prokurorial, në atë mënyrë që garanton një informacion objektive, korrekte çoftë përmes zëdhënësve të prokurorive, pastaj web faqeve pranë KPK-së dhe prokurorisë së Shtetit, duke publikuar raportet e punës nga institucioni i Prokurorisë, dhe ky komunikim duhet të behet edhe me QJQ dhe Shoqërinë civile, në atë mënyrë që mos të dëmtohet çfarëdo informate apo zbulim i fshehtësisë zyrtare me çka do të rrezikohej edhe procesi i hetimeve.

2.Cilat janë planet tuaja për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?

Synimet kryesore për mua si kryeprokurore është që puna e kësaj prokurorie të jetë sa më cilësore. Pa mëdyshje si drejtuese e prokurorisë mendoj se rendësi dhe garantues ne sukses raporti i shëndosh dhe i mirëfilltë ne mes të eprorit në një anë dhe prokurorit dhe stafit mbështetës të prokurorisë në anën tjetër, vlerësoj se edhe në të ardhmen këto raporte të shëndosha, kolegjiale, nder njerëzore ne mes të gjithë artereve brenda institucionit të prokurorisë duhet të avancohen gjithnjë sepse është mënyra e vetme që siguron suksesin e një prokurorie, njëkohësisht edhe në ngritjen e besimit reciprok dhe hapësirës për mendim profesional të ndryshëm për një çështje apo ekspertizë profesionale. Do të planifikohen takime të rregullta dhe periodike me vartësit, ku do të diskutohen të gjitha problemet vështirësitë, të metat që vërehen gjatë punës së përditshme por edhe sukseset brenda vetë institucionit të prokurorisë dhe i gjithë diskutimi do të jetë në interes të përmirësimit dhe funksionimit sa me efikas të prokurorisë, identifikohen problemet dhe paraqitet zgjidhje për to. Me qellim të sigurohet punë cilësor në

prokurori planifikoj të strukturë organizative ku do të jenë pjesë përgjegjësit të departamenteve dhe koordinatorët pasi vlerësoj se me këtë do të sigurohet punë cilësore kjo për faktin se me një se menjë menaxhim profesional duke ndarë përgjegjësit tek përgjegjësit e departamenteve do të arrihet të kontrollohet edhe kualitetin e të gjitha akteve dhe veprimeve nga prokurorët dhe stafit mbështetës në drejtim të arritjes së rezultateve të kënaqshme për prokurorinë dhe në këtë mënyrë do të rrisim profesionalizmin në punën e prokurorëve dhe besimin e publikut do të instaloj në sistem kontrolli të çdo akuze para se të dërgohet në Gjykatë.


3.Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënies së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?

Do të kërkoj në vazhdimësi nga prokurorët të jenë të sjellshëm, të ndershëm, të jenë me sjellje dhe cilësi personale dhe jo vetëm që duhet të jenë të ndershëm por edhe të duken të tillë sepse betimi i publikut është kyç për të legjitimuar një prokuror të pavarur dhe të paanshëm. Do të angazhohem që si drejtues i prokurorisë ti mbaj vartësit e mi në binarët e profesionalizmit, pavarësisë, paanësisë, por edhe në binarët e transparencës dhe komunikimit me media dhe publikun, pa dëmtuar asnjëherë të drejtat e personave nën hetim, por duke respektuar gjithmonë parimin e prezumimit të pafajësisë. Si udhëheqës i prokurorisë nuk do të ngurroj të jap udhëzime dhe detyrime të qarta të gjithë vartësve të mi duke llogaritur ndikimin e tyre në përmirësimin dhe suksesin në institucionin e prokurorisë . Si drejtuese e Prokurorisë rezultatet, do ti paraqes në institucionet kompetente në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, në Këshillin Prokurorial të Kosovës si dhe në komisionet kompetente për vlerësimin e përfomances, njëkohësisht duke bërë vlerësimin vjetor të punës për prokurorët të Prokurorisë përkatëse si në aspektin profesional ashtu edhe në aspektin e integritetit të këtyre Prokurorve të cilën e menaxhoj. Po ashtu mendoj se përfomancës të prokurorëve nga Këshilli Prokurorial të Kosovës viteve të fundit ju është kushtuar vëmendja e nevojshme çoftë me rastin e shqyrtimit të përfomances për prokurorët me mandat fillestar, çoftë prokurorëve me mandat të përhershëm. Gjithashtu si eprori i prokurorisë mendoj se edhe në të ardhmen duhet edhe me tej të bëhen përpjekje për ngritjen e nivelit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies nga eprori i çdo prokurorie përkatëse, tek prokurorët dhe stafi mbështetës, si bazament dhe udhërrëfyes për një sistem prokurorial të përgjegjshëm funksional e të pranueshëm për të gjithë qytetarët e Republikës të Kosovës, dhe çdo dështim në këtë drejtim do të sjell përgjegjësi çka edhe duhet të jetë ndjekur edhe me masa adekuate bazuar në ligj. Edhe pse jam i vetëdijshëm se një vendim në shërbim dhe interes të sistemit prokurorial, mund të mos jetë i pëlqyeshëm dhe shumë popullor, por forca dhe mesazhi që del nga një vendim i tillë i shërben avancimit dhe ngritjes së imazhit të institucionit të prokurorisë dhe njëkohësisht rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në sistemin prokurorial.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij Koncept dokumenti e kam përgatitur vetën dhe jam në dijeni se pas emërimit, i njëjti do të publikohet në faqet zyrtare.

Nënshkrimi: _____

Datë: 06.11.2024

A handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping loops and a long horizontal stroke, positioned over the signature line.